

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Numbeo: Shqipëria ndër më të shtrenjtat në rajon për të ngrënë një vakt jashtë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/numbeo-shqiperia-nder-me-te-shtrenjtat-ne-rajon-per-te-ngrene-nje-vak-i106307
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 14:00:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:48:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	844574bcc9721abb018a0155bbdda88431c8ae1e4b3b0dfe10c7b49b7674e9ee
TEKSTI	28c6683793cd20895027245e2a722ef1b363e6fc01c5a6e26db910452cc29870
PAMJA	223064522586879c5cc5a116372fb50dc02111ac896d84631fbfa90a1fc4be32

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3287b61d602b8e2ea47ff0b7f111280b8993686175717604f8f782f417e75268
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afd7b89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3287b61d602b8e2ea47ff0b7f111280b8993686175717604f8f782f417e75268>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **per te ngrënë një vakt** mesatarisht 10.10 dollarë, një nivel më i lartë se në Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, por më i ulët se në Mal të Zi. Në renditjen e 98 vendeve dhe territoreve sipas kostonë së një vakti në një restorant të lirë, Shqipëria pozicionohet në vendin e 43-të dhe rezultojnë gjithashtu mbi mesataren globale prej 9.35 dollarësh.

■ **deputetet: Pisanjosë me kostum** shtrënjtë nga krimi i organizuar.

■ **hysenin. Driane referenca të mira** mbi emërimin e Vlora

■ **mbledhen sot në sheshin "Skënderbeu"** mblidhen në mbështetj...

■ **sulmojë median** drejtueses së SHISH,

[AKTUALITET](#)

Numbeo: Shqipëria ndër më të shtrenjtat në rajon për të ngrënë një vakt jashtë

Piranjat Përditësimi i fundit 27 Shtator 2026, 15:48



Të hash në një restorant me çmime të ulëta në Shqipëri kushton mesatarisht 10.10 dollarë, një nivel më i lartë se në Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, por më i ulët se në Mal të Zi. Në renditjen e 98 vendeve dhe territoreve sipas kostonë së një vakti në një restorant të lirë, Shqipëria pozicionohet në vendin e 43-të dhe rezultojnë gjithashtu mbi mesataren globale prej 9.35 dollarësh.

Mes vendeve të rajonit të paraqitura në të dhënat e Numbeo vetëm Mali i Zi është më i shtrenjtë se Shqipëria, me një vakt mesatar prej 11.68 dollarësh dhe vendin e 35-të në renditje. Serbia ndodhet shumë pranë Shqipërisë, me 9.96 dollarë, vetëm 14 cent më pak, ndërsa diferenca zgjerohet ndjeshëm me Maqedoninë e Veriut, ku një vakt kushton 7.60 dollarë, dhe me Kosovën, ku çmimi zbret në 5.84 dollarë. Kjo do të thotë se një vakt i kësaj kategorie në Shqipëri kushton rreth 2.50 dollarë më shumë se në Maqedoninë e Veriut dhe 4.26 dollarë më shumë se në Kosovë.

Të dhënat e Numbeo krahasojnë çmimin e një vakti në atë që në secilin vend konsiderohet një restorant me kosto të ulët. Pra, nuk bëhet fjalë për të njëjtën pjatë të shitur në 98 vende të ndryshme. Çmimet raportohen nga përdoruesit dhe konvertohen në dollarë amerikanë me kursin e tregut, pa u korrigjuar sipas fuqisë blerëse.

Diferenca 19-fish mes vendit më të shtrenjtë dhe më të lirë

Në rang global, heneku është shumë i madh. Zvicra është vendi më i shtrenjtë në renditje, ku një vakt në një restorant të lirë kushton mesatarisht 31.20 dollarë, ndërsa në Bangladesh vetëm 1.63 dollarë. Diferenca është rreth 19 herë.

Pas Zvicrës renditet Norvegjia, me 23.60 dollarë, ndërsa vendet nordike dhe ato të Beneluksit dominojnë pjesën e sipërme të tabelës. Në Danimarkë një vakt kushton 23.43 dollarë, në Belgjikë dhe Holandë 23.36 dollarë, ndërsa në Irlandë 23.35 dollarë.

Në total, 17 nga 20 vendet më të shtrenjta janë europiane. Përjashtimet janë Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe Australia. SHBA renditet e nënta, me një çmim mesatar prej 20 dollarësh, dhe është i vetmi vend jashtë Europës në dhjetëshen e parë.

Megjithatë, Evropa ka diferenca të fortë brenda saj. Ndërsa Zvicra kryeson me 31.20 dollarë, Kosova me 5.84 dollarë ndodhet në skajin tjetër të kontinentit. Për krahasim, Hungaria rezultojnë në 12.88 dollarë dhe Bullgaria në 11.94 dollarë.

Japonia, vendi më i lirë i G7 për të ngrënë jashtë

Një tjetër rezultat që bie në sy është Japonia. Ajo renditet në vendin e 69-të nga 98, me një kosto prej vetëm 6.29 dollarësh për një vakt në një restorant të lirë. Japonia është vendi më i lirë i G7 për këtë tregues dhe i vetmi anëtar i grupit që ndodhet nën median globale.

Për krahasim, në Francë dhe Gjermani një vakt kushton pothuajse tre herë më shumë. Çmimi relativisht i ulët në Japoni nuk lidhet me mungesën e një industrie të zhvilluar të restoranteve; vendi renditet i treti në botë për numrin e restoranteve me yje Michelin, pas Francës dhe Italisë.

Azia dhe Afrika dominojnë fundin e renditjes

Vendet me çmimet më të ulëta gjenden kryesisht në Azi dhe Afrikë. Pas Bangladeshit me 1.63 dollarë, renditen Indonezia me 1.70 dollarë dhe Bolivia me 1.73 dollarë. Në Nigeri një vakt kushton 1.85 dollarë, në Nepal 1.96 dollarë, në Indi 2.09 dollarë, në Pakistan 2.16 dollarë, ndërsa në Kinë 2.98 dollarë.

Nga 20 vendet më të lira në renditje, 11 janë në Azi dhe pesë në Afrikë. Gjashtë nga dhjetë vendet më të populluara të botës ndodhen gjithashtu mes 20 vendeve ku një vakt në restorant kushton më pak. /ekofin.al

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 27 Shtator15:32

[Transportonte emigrantë të paligjshëm, arrestohet një person në Maliq](#)

Një person ka rënë në pragat e policisë ditën e sotme në Maliq pasi dyshohet se transportonte emigrantë në më...

AKTUALITET 27 Shtator14:22

[Zjarr në çatinë e një hoteli në qendër të Shkodrës](#)

Një zjarr ka përfshirë çatinë e një hoteli në qendër të qytetit të Shkodrës, duke shkaktuar panik te ...

AKTUALITET 27 Shtator13:40

[Atentati në Athinë/ Ja çfarë i tha Denis Luli kamarierit para sulmit](#)

Sipas informacioneve të reja, katër autorët mbërritën në lokal me një automjet të vjedhur të enjten e kaluar në...

AKTUALITET 27 Shtator13:36

[Pacienti ndërroi jetë, nisin hetimet për dy mjekët neurologë](#)

Dy mjekë neurologë të Spitalit Rajonal të Shkodrës janë proceduar penalisht në gjendje të lirë, ndërsa ndaj ...

AKTUALITET 27 Shtator13:02

[Në kërkim nga autoritetet italiane dhe kosovare, dy të arrestuar në Tiranë, pritën ekstradimi](#)

Dy persona të shpallur në kërkim ndërkombëtar janë arrestuar në Tiranë dhe në Rinas, në kuadër të ...

AKTUALITET 27 Shtator12:51

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Haklaj ndalohet në kufirin e Bilatës](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare të&...

AKTUALITET 27 Shtator12:34

[Gjykata e Lartë nuk shkon në tryezën e Ramës për pagat, Sadushi: Çështja është në Kushtetuese](#)

Gjykata e Lartë nuk do të përfaqësohet në tryezën e thirrur për nesër nga kryeministri Edi Rama me institucionet e Dre...

AKTUALITET 27 Shtator12:33

[Lëviz tonelata me kokainë/ Ky është Sokol Bibaj, “Pitbulli” që del në dosje me Salvatore Aliun](#)

Sokol Bibaj, i njohur me nofkat “Gus”, “Gusti” dhe “Pitbull”, është një prej personave të shpallur në...

AKTUALITET 27 Shtator12:32

[Policia ndalon për kontroll ‘Benzin’ luksoz, rezulton i kërkuar nga Interpol Manchester](#)

Një automjet luksoz tip “Benz”, prodhim i viteve të fundit, është sekuestruar në Fier pasi nga verifikimet e policisë...

AKTUALITET 27 Shtator11:44

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian publikon foton e ngjashme me Rajmonda Kotorrin që u zhduk 16 vjeçe në Itali](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 26 Shtator

[Thirrja “urgjente”/ Rama mesazh shqiptareve nga...](#)

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t'u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

AKTUALITET 26 Shtator

[Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit ...](#)

Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të d...

AKTUALITET 26 Shtator

[Autobusi përfshihet nga flakët në hyrje të tune...](#)

Një autobus është përfshirë nga flakët në hyrje të tunelit në Elbasan. Për shkak të incidentit, rruga &e...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.